



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22.4.2023

Nr: 399

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË QV NR. 1977/00, QV NR. 1977/01, QV NR. 1977/02, QV NR. 1977/03, QV NR. 2021/00, QV NR. 2021/01, BASHKIA TIRANË, QV NR. 1080/00 BASHKIA BULQIZË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar propozimi i administratorit të Njesisë Administrative nr. 9, të autorizuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të 4 (katër) qendrave të votimit, konkretisht të QV nr. 1977, QV nr. 1977/01 dhe QV nr. 1977/02, QV nr. 1977/03, nga ambientet e Policisë Bashkiake (ish Aluizni) në shkollën “7 Marsi”, si institucioni me i afërt publik me zyrat e Policisë Bashkiake.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar propozimi i administratorit të Njesisë Administrative nr. 11, të autorizuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, për dhënie autorizim për ngritjen e 2 (dy) qendrave të votimit në ambiente private, konkretisht të QV nr. 2021/00, QV nr. 2021/01 në lokalitë e z. Xhevahir Hysa, me arsyetimin se këto dy ambiente i plotësojnë kushtet për të shërbyer si qendra votimi dhe kanë shërbyer dhe në zgjedhjet e shkuara.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar propozimi i kryetarit të Bashkisë Bulqizë, për dhënie autorizim për ndryshimin e vendndodhjes së 1 (një) qendre votimi, konkretisht të QV nr. 1080 me adresë Trebisht-Celebi (shkolla) të kalojë në shkollën 9-vjecare

Data: 22.4.2023 Nr: 399
Ora: 12:00



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1977/00, QV nr. 1977/01, QV nr. 1977/02, QV nr. 1977/03, QV nr. 2021/00, QV nr. 2021/01, Bashkia Tiranë dhe QV nr. 1080/00 Bashkia Bulqizë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”

“10 Dëshmorët Trebisht”, në fshatin Muçinë, me arsyetimin se u shërben më mirë zgjedhësve të asaj zone zgjedhore.

Nga verifikimi i kryer në terren nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezulton e njëjta situatë sikundër referohet nga administratorët e Bashkisë Tiranë dhe nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1977, QV nr. 1977/01, QV nr. 1977/02, QV nr. 1977/03 duke i caktuar në shkollën ‘7 Marsi’.
2. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 2021/00 dhe QV nr. 2021/01 ne ambient lokal me pronar z. Xhevahir Hysa.
3. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1080 ne shkollën 9-vjecare “10 Dëshmorët “, Trebisht.
4. Administratorët e njësisve administrative të afishojnë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
5. Administratorët e njësive administrative të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI